

Numri i lëndës: 2020:163098

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05500820

C.nr.1016/2020

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V., gjyqtari Raif Fazliu, me bashkëpunëtorin profesional, Agon Halabaku, në çështjen juridike kontestimore të paditëses, L.A.nga V., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. X.H., nga V., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “ELSIG”, me seli në Prishtinë, rr.”Tringë Smajli” nr.18, me objekt të kontestit anulimi i marrëveshjes jashtëgjyqësore, në vlerë prej 1,000.00 €, më datë 25.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Konstatohet e tërhequr padia e paditëses, L.A., nga V., me objekt të kontesti anulimi i marrëveshjes jashtëgjyqësore, e ushtruar më 23.11.2020, kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve “ELSIG”, me seli në Prishtinë.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, lënda me shenjë C.nr.1016/20, arkivohet në arkivin e gjykatës.

II. Secila palë do ti bart shpenzimet e veta të procedurës të krijuara deri më tani.

A r s y e t i m

Më datë 23.11.2020, paditësja, L.A., nga V., përmes të autorizuarit të saj av. X.H., ka ngritur padi kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve “ELSIG”, me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit anulimi i marrëveshjes jashtëgjyqësore, në vlerë prej 1,000.00 €.

Të paditurës, Kompania e Sigurimeve “ELSIG”, me seli në Prishtinë, me datë 18.11.2022, gjykata kishte nxjerr aktvendim me të cilën e kishte detyruar për përgjigje në padi, nën pasojat procedurale. Në përgjigjen në padi, të datës 09.12.2022, e paditura në tërësi e kishte kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, për anulimin e marrëveshjes jashtëgjyqësore.

Me datë 21.03.2024, përfaqësuesi i autorizuar i paditëses, av.X.H., ka ushtruar parashtresë për tërheqjen e padisë, pasi që me të paditurën kishin arritur pajtim jashtëgjyqësor.

Pasi që pala aktive në procedurë, vullnetarisht e ka tërhequr padinë, gjykata në kuptim të nenit 261 paragrafët 2, 3 dhe 4, të LPK-ës, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, duke respektuar vullnetin e palës paditëse padinë e konstaton të tërhequr.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë duke u bazuar në nenin 450. të LPK-së

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA E GJYKATËS V.

C.nr.1016/2020 datë, 25.03.2024

G j y q t a r i
Raif Fazliu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve pas ditës së pranimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet në këtë Gjykatë.

